

VENDIM
Nr. 187, datë 21.7.2022

**MBI KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT,
HEC “VAU I DEJËS” I SHOQËRISË “KESH” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 8 të rregullores “Për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; të nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-sP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1144/9 prot., datë 20.7.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kualifikimin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC ‘Vau i Dejës’ i shoqërisë ‘KESH’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 912 prot., datë 13.6.2022, shoqëria “KESH” sh.a., ka paraqitur në ERE një kërkesë për kualifikimin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit në HEC “Vau i Dejës” si impiant gjenerues i energjisë së rinovueshme.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar tërësisht.

- Në mbështetje të këtij parashikimi, iu drejtuam Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me shkresën nr. 912/1 prot., datë 22.6.2022, me kërkesën për të paraqitur në ERE raportin e komisionimit të centralit fotovoltaik të digës së Qyrsaqit, në HEC-in e “Vaut të Dejës”.

- Në përgjigje të sa më sipër, OST sh.a., me shkresën nr. 4026/1 prot., datë 28.6.2022, protokolluar në ERE me nr. 912/2, datë 29.4.2022, ka bërë me dije se impanti i digës së Qyrsaqit është energjizuar në datën 13.5.2022, në zbarët 10 kV në N/st 220/110/10 kV të “Vaut të Dejës” dhe ka përcjellë bashkëlidhur edhe përgjigjen finale të inspektimeve të grupit të punës, nga e cila rezulton se është miratuar energjizimi i impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KESH” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti